



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – RepublicofKosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština – Municipality of Prishtina

## EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

i mbledhjes së nëntë i Kuvendit të Kryeqytetit të Republikës së Kosovës, mbajtur më 30.11.2023, e cila filloj në orën 11:00.

Në mbledhje morën pjesë: Pëllumb Bajçinovci, kryesues i Kuvendit, (LDK), Tiera Kasumi-Berisha (LVV), Ermal Osmani (LVV), Feim Osmani (LVV), Gëzim Sveçla (LVV), Nora Kelmendi (LVV), Arianit Beqiri (LVV), Petrit Reçica (LVV), Mirsad Vitia (LVV), Faton Zeka (LVV), Edmond Azemi (LVV), Violeta Salihu (LVV), Radie Hoxhaj, (LVV), Besart Krasniqi (LVV), Arbnora Berisha (LVV), Berna Saraçi (LVV), Jeta Rafuna-Hasani (LDK), Ajet Brajshori (LDK), Dasmor Durmishi (LDK), Milazim Vitija (LDK), Sami Salihu (LDK), Amir Simnica (LDK), Driton Rukiqi (LDK), Hafiz Krasniqi (LDK), Dhurata Jahaj-Retkoceri (LDK), Lindita Rexhepi (LDK), Donjeta Dragusha (LDK), Elmire Nikçi-Rexha (LDK), Fikneta Bejta (LDK), Leutrim Retkoceri (PDK), Muhamet Selmani (PDK), Agron Canolli (PDK), Arbnora Ajeti (PDK), Shegë Beqiri-Badivuku (PDK), Fatmir Dervishi, (PDK), Granit Geci (PDK), Liridon Selmani, (PDK), Kumrije Shabani-Ramadani (PDK), Gresa Lahu (PDK), Bahri Gashi (AAK), Kushtrim Mushica (AAK), Taulant Maxharraj (AAK), Endrit Gashi (AAK), Valbona Ajeti (AAK), Sami Boroci (AKR), Gëzim Mehmeti (AKR), Agim Kuleta (LB).

**Munguan:** Berat Lahu (LVV), Besnik Mujeci (LVV), Fehmi Kupina (i pavarur) dhe Endrit Zabërgja (NISMA).

**Të pranishëm ishin edhe:** Donjeta Sahatçiu - nënkyetare, Alban Zogaj - nënkyetar, Vigan Kastrati - drejtore i Drejtorisë së Administratës, Mimoza Sylejmani - drejtore e Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, Granit Rugova - drejtore i Drejtorisë së Sportit, Plator Gërdovci - drejtore i Drejtorisë së Bujqësisë, Valbona Makolli - drejtore e Drejtorisë së Financave, Osman Bllaca, përfaqësues të OSBE-së dhe përfaqësues të medieve.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Pëllumb Bajçinovci, kryesues i Kuvendit, i cili hapi diskutimin rreth pikave të rendit të ditës.

*Në momentin kur filluan diskutimet rreth rendit të ditës, u shfaqen disa probleme teknike në incizimin e mbledhjes dhe në pamundësi për evitimin e tyre, kryesuesi propozoi një pauzë prej 1 orë e 20 minuta.*

**Sami Boroci:** - propozoi që pika e dytë e rendit të ditës: Projektrregullorja për organizimin

## Faqe1nga9

dhe shfrytëzimin e parkingjeve të Komunës së Prishtinës të zhvendoset në një seancë tjetër ose të jetë pika e fundit në rend të ditës, me ç'rast tha se për këtë projektrregulllore kam vërejte dhe disa komente, të cilat duhet të diskutohen më në detaje.

**Gëzim Sveçla:** - fillimisht shprehi paknaqësi në lidhje me veprimet që po ndodhin në Kuvendin Komunal të Prishtinës, duke filluar nga anulimi i seancës së jashtëzakonshme dhe ngjarja e sotit që ka ndodh, ku në orën 8:30 minuta ka qenë e paraparë të fillojë mbledhja e KPF-së, ajo nuk ka filluar deri në ora 9:15 minuta, ku kemi pritur që në mbledhje të jenë prezent edhe përfaqësuesit e pushtetit lokal. Kjo tregon një mungesë respekti që e keni edhe ndaj këtij komiteti, i cili është komiteti më i lartë i Kuvendit Komunal të Prishtinës, si dhe në përgjithësi po e shpërfaqni qasjen tuaj që e keni ndaj Kuvendit.

**Bahri Gashi:** - me diskutimin e tij kryesisht u ndërlidh rreth anulimit të mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit, si dhe përmospjesëmarrje në mbledhjen e KPF-së, i cili tha se sot "Sot ishim dëshmitarë të një situate jo të mirë, kur në neglizhencë e në mungesë edukate të disave, na detyrojnë me u largu prej Komitetit për Politikë dhe Financa, sepse deri në ora 9 ne pritëm dhe nuk erdhi kerkush". Sa u përket pikave të rendit të ditës, propozoi që Projektrregullorja për organizimin dhe shfrytëzimin e parkingjeve të Komunës së Prishtinës, dhe Projektrregullorja për menaxhimin e mbeturinave dhe Plani komunal i menaxhimit të mbeturinave 2023-2027, të hiqen nga rendi i ditës, të shtyhen përmospjesëmarrje në seancë tjetër.

**Feim Osmani:** - tha se këto dy pika, Projektrregullorja për organizimin dhe shfrytëzimin e parkingjeve të Komunës së Prishtinës, dhe Projekt-rregullorja për menaxhimin e mbeturinave dhe Plani komunal i menaxhimit të mbeturinave 2023-2027, duhet të hiqen nga rendi i ditës, të shtyhen përmospjesëmarrje në seancë tjetër dhe të trajtohen vetëm këto dy tema, sepse është material voluminoz.

**Sami Salihu:** - propozoi që në seancat e tillë ku në rend të ditës ka përmospjesëmarrje në seancë tjetër, përfaqësuesit nga Zyra ligjore.

**Kryesuesi:** - tha se Zyra ligjore deri në këtë fazë i ka interpretuar rregulloret dhe i ka përfunduar krejt çka është kërkuar prej tyre. Mendoj se çdo rregullore e cila kalon dhe ju mendoni se ka shkelje ligjore, janë organet e larta, është Ministria e Pushtetit Lokal e cila do ta shqyrtojë at rregullore.

**Jeta Rafuna Hasani:** - propozoi që Projektrregullorja për Prishtina Parking, të zhvendoset në fund të rendit të ditës, përsye se kryetari i komisionit përmomentin nuk ka mundësi të jetë prezent në mbledhje.

**Gëzim Mehmeti:** - ngriti shqetësim duke cekur se, përderisa ne këtu nuk e shohim hartuesin e rregullores në këtë rast komisionin, nuk e shohim të pranishëm zyrtarin ligjor, atëherë na jep shumë ndjenjën që kjo ka ardhur pa kaluar nëpër instancat e nevojshme dhe mendoj se kjo paraqet një joseriozitet jashtëzakonisht të madh ndaj qytetarëve të cilët në këtë rast do të janë të dëmtuar.

**Nora Kelmendi:** - tha se pse nuk e keni sjell në Kuvend Planin rregullues përmospjesëmarrje "Emshir", kërkoi të dijë arsyen e mossjelljes së tij.

**Valbona Ajeti:** - shprehu paknaqësi përmospjesëmarrje së tij, e cila tha se të sillemi një orë nëpër kafenetë e Prishtinës e mos të rregullohet një mikrofon e një zërim është e papranueshme. Po ashtu shprehu edhe indinjatën përmospjesëmarrje së tij, në 8 e 30 është thirr takimi, joseriozitet deri në orën 9 e 10 minuta mos të fillojë. Gjithashtu konsideroi se është e

papranushme që keni sjellë një draftrregullore për votim e në fakt ajo paraprakisht duhet të punohet mirë dhe më pas të sjellet për diskutim dhe votim.

**Leutrim Retkoceri:** - tha se në mbledhjen e kaluar të Komitetit për Politikë dhe Financa, të gjitha këto rregullore që janë të propozuara në rendin e ditës, i kemi diskutuar dhe kemi dhënë rekomandime për plotësimë dhe inkorporim të vërejtjeve nga të gjitha grupet. Këto dy rregullore kanë edhe defekte të mëdha dhe si të tilla janë ende në fuqi. Mendoj se këto rregullore duhet t'i diskutojmë, t'i plotësojmë, t'i ndryshojmë, kjo është detyra dhe puna që na e ka dhënë si përgjegjësi qytetari i kryeqytetit.

**Kryesuesi** i hodhi në votim propozimet e dhëna për pikat e rendit të ditës.

**Kryesuesi konstatoi se më 26 vota për, u miratua propozimi që pika e dytë e rendit të ditës: Projektrregullorja për organizimin dhe shfrytëzimin e parkingjeve të Komunës së Prishtinës, zhvendoset në pikën e dhjetë të rendit të ditës.**

**Kryesuesi konstatoi se më 8 vota për dhe 24 vota kundër, nuk hiqen nga rendi i ditës Projektrregullorja për organizimin dhe shfrytëzimin e parkingjeve të Komunës së Prishtinës, Projektrregullorja për menaxhimin e mbeturinave dhe Plani komunal i menaxhimit të mbeturinave 2023-2027, por mbesin në rendin e ditës për diskutim.**

**Me propozimet e dhëna për ndryshim të pikave të rendit të ditës, më 26 vota për u miratua ky:**

#### Rend dite

- Miratimi i ekstraktit të procesverbalit i mbledhjes së tetë të Kuvendit të Kryeqytetit;**
- Projektrregullorja për menaxhimin e mbeturinave dhe Plani komunal i menaxhimit të mbeturinave 2023-2027;**
- Propozim-rregullorja për përcaktimin e procedurave dhe formave për dhëni së shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për më pak se një vit;**
- Propozim-rregullorja për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores mbi taksën administrative për dhëni e lejes së ndërtimit dhe tarifën për rregullimin e infrastrukturës, 01-434/01-0094474/17, dt. 24.04.2017;**
- Propozim-vendimi për caktimin e shkallës tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2024;**
- Propozim-vendimi për heqjen e taksës për vulën në transaksion;**
- Propozim-vendimi lidhur me Planin e integritetit në Kryeqytetin Prishtinë 2023-2026;**
- Propozim-vendimi lidhur me Planin lokal të veprimit për cilësinë e ajrit në Komunën e Prishtinës 2023-2027;**
- Raport periodik për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit për vitin 2022;**
- Projektrregullorja për organizimin dhe shfrytëzimin e parkingjeve të Komunës së Prishtinës;**

---

#### Faqe3nga9

## **11. Pyetje dhe përgjigje;**

### **12. Të ndryshme.**

#### **Pika e parë**

**Miratimi i ekstraktit të procesverbalit i mbledhjes së tetë të Kuvendit të Kryeqytetit.**

**Kryesuesi konstatoi se më 26 vota për u miratua ekstrakti i procesverbalit i mbledhjes së tetë të Kuvendit të Kryeqytetit.**

#### **Pika e dytë**

**Projektrregullorja për menaxhimin e mbeturinave dhe Plani komunal i menaxhimit të mbeturinave 2023-2027.**

Arsyeshmérinë për votimin e kësaj projektrregulloreje dhe të Planit komunal për menaxhimin e mbeturinave e paraqiti Ilirik Musliu - drejtor.

**Arianit Beqiri:** - tha se hartimi i një rregulloreje të mirë e cila do t'i shërbente kryeqytetit, për një kohë relativisht të gjatë, do të ishte e pranueshme për ne dhe gjithsesi për banorët e Prishtinës. Vlerësimi se duhet të ketë të drejtë Komuna të lëshojë leje për operatorët tjerë edhe nëse nuk bie ndesh me ligjin, në rastin më të keq bie ndesh me politikat menaxheriale që janë bërë deri me sot, në raport me ndërmarrjen "Pastrimi", duke krijur shpenzime shtesë nga buxheti komunal, si dhe do të ndikonte negativisht në qëndrueshmérinë financiare të ndërmarrjes. Aspekti i dytë, se pse kjo projektrregullore nuk duhet miratuar kështu siç është propozuar, është ngritja e çmimeve për të gjitha kategoritë e shërbimeve..

E dyta, është se a është përmirësuar shërbimi i grumbullimit të mbeturinave, pra që do ta arsyetonte këtë ngritje të çmimeve edhe çështja e tretë, a ka mungesë të mjeteve financiare Komuna e Prishtinës, se nuk mund të realizojnë më tepër se 30%, të buxhetit që e kishin në dispozicion. Sikur të mos ishte mjaftueshëm shqetësuese fakti, se në dokumentin e parafundit, kjo projektrregullore është ndryshuar disa herë, që përmes adresave tona elektronike, për neve si grup ka qenë pak e vështirë përgatitja e temës dhe diskutimeve për shkak të ndryshimeve të shpeshta. Për ne si grup, nuk mendojmë se mund të zgjidhen problemet në këtë formë, pra problemet të cilat janë shkaktuar nga keqmenaxhimi nuk mendojmë se zgjidhen duke i ngarkuar qytetarët me një taksë shtesë. Kjo projektrregullore dhe ky plan nuk është i mjaftueshëm dhe nuk i adreson të gjitha problemet e qytetarëve.

**Dasmor Durmishi:-** tha se ne si GP i LDK-së e kemi analizuar rregullorën në detaje, andaj vlerësojmë angazhimin e secilit të finalizohet, pasi që kjo rregullore ka qenë mëse e nevojshme për kompaninë "Pastrimi".

**Muhamed Selmani:** - fillimisht me diskutimin e tij u përqendrua rrëth rritjes së çmimeve për të cilat dha arsyeshmëri të nevojshme, kështu që kërkoi nga anëtarët e Kuvendit që të përkrahët kjo projektrregullore për ndryshime dhe plotësimë, pasi që është tentativa e parë pas disa viteve, që po tentohet së paku të bëhen ndryshime për të parë ndoshta rezultate më të mira në nivelin e pastrimit të qytetit. Sa i përket gjendjes nuk kemi pse të flasim, ajo ka qenë katastrofike, është përmirësuar dukshëm, kurse vetëm flotën e kemi të rritur dikun prej 30%, prej asaj që e kemi gjetur e kemi rritur.

Sasia e gumbullimit të mbeturinave është rritur në kuadër të 30%, megjithatë niveli i rritjes së mbeturinave në qytet është shumë alarmante, sidomos mbeturinave inerte, mobile dhe ndërtimet, të cilat janë duke shkaktuar nivelin më të madh të tyre.

**Bahri Gashi:** - tha se pse duhet me u rrit çmimi nëse nuk kemi efikasitet të punës, por në kushtet sot që jemi nuk ka ndonjë grumbullim siç duhet të mbeturinave, ka mungesë edhe të kontejnerëve. Rregullorja parashë lloj-lloj të kontejnerëve, që ka me qenë barrë edhe për biznesin edhe për familjet, sidomos për biznesin, sepse çdo biznes do të jetë i detyruar që të marrë një kontejner të veçantë, sipas rregullores. Mendoj se duhet të gjemë një mes të përbashkët për të parë dhe menduar për të gjithë qytetarët, pra nësë rritet çmimi nuk do të jetë zgjidhje për qytetarët. Konsideroj se çmimi nuk duhet me u rrit, mendoj se duhet me u përsosur shërbimi dhe pastaj të flasim për tjerë çështje.

**Sami Boroci:** - fillimi shqiptar se ne nuk mundemi me akuzu shumë këtë ndërmarrje pa e përkrah dhe pa i kriju mundësi që kjo ndërmarrje me ofru shërbim në qytet. Nuk jam kundër rritjes simbolike të çmimit, vetë kjo rritje duhet me u sinkronizu, duhet me u mbështet në shërbim të mirë, duhet me qenë të bazuara në ngritjen edhe të shërbimit. Përderisa është ndërmarrje rajonale, mendoj se kanë për t'na përcjellur vazhdimisht probleme të tilla, kështu që mendoj se është dashtë të punohet në atë drejtim që kjo ndërmarrje të jetë e qytetit të Prishtinës. Shpresoj se kjo rregullore ka me i hap rrugë, një shërbimi ose një organizmi ose një vetqëndrueshmërie të kësaj ndërmarrjeje.

**Nora Kelmendi:** - tha se sa i përket faturave të mbeturinave, kemi shumë ankesa prej qytetarëve, që faturat nuk po ju sillen qytatarëve përmes postës, kështu që edhe tash në bazë të kësaj rregullorjeje nuk po vërej se sa është i zgjidhur ky problem.

**Berna Saraçi:** - propozoi që nga pagesa e faturës së mbeturinave të lirohen bizneset e vogla artizanale, specifisht zejtaret, të cilët të vetmin shërbim që e kanë është riparimi i produkteve, pra këpucëtarët, rrobaqepësit, ortarët, të cilët vetëm riparojnë produkte ekzistuese dhe i sjellin përsëri në përdorim ato.

**Gëzim Sveçla:** - tha se nëse kjo projektrregullore kalon filtrat ligjorë dhe hyn në fuqi, kur mendojmë se do të japë rezultatet e para dhe kur do të kemi një Prishtinë të pastër. Kur do të shihen hapat e parë në drejtim të largimit të kësaj situate, lirisht kisha me quajtë emergjente, sidomos gjatë muajve të verës, ku të gjithë e dimë se nga Kuvnedi ndërmarrja "Pastrimi" është subvencionuar tri herë gjatë këtyre dy viteve. Po ashtu kërkoi të dijë se çështja e borxhit në deponi, a është tanimë ky borxh në vlerat që ka qenë, apo sa i kemi borxh deponisë për këtë çështje.

**Faton Zeka:** - tha se a ka ndonjë statistikë, a është mbulueshmëria e inkasimit të mbeturinave në 100% të ekonomive familjare dhe biznesore në Prishtinë, sepse në kohën sa unë kam qenë kryesues i komisionit për mbeturina, kjo është bërë që fatura e mbeturinave nga Komuna e Prishtinës, e ka pas për bazë tatimin në pronë. A është mendu ndonjë strategji që të evidentohen të gjitha ekonomitë, të cilat gjenerojnë mbeturina dhe të bëhen pjesë e inkasimit.

**Leutrim Retkoceri:** - tha se kjo është rregullore e Komunës së Prishtinës që tenton të vë në rregull këtë çështje, por realizuesi është një ndërmarrje publike e cila siç e dini të gjithë ka dhe ka pas probleme jashtëzakonisht të mëdha në funksionim, në operativë, në financim dhe është një ndërmarrje e cila prej të gjitha ndërmarrjeve përbën borxin më të madh që ndërmarrjet publike e kanë pas. Unë mendoj se janë përfshirë disa prej propozimeve që kanë qenë në Komitetin për Politikë dhe Financa edhe propozimi i znj. Saraçi e që ne si grup parlamentar e mbështesim këtë propozim.

**Hafiz Krasniqi:** - tha se sa i përket propozimit të znj. Saraçi, megjithatë nuk mendoj se duhet të lirohen komplet, sepse edhe ata janë një kategori që të paktën krijojnë mbeturina. Duhet t'i përkrahim që këto kategoritë bizneseve të kategorizohen me ekonomitë familjare, kështu që mendoj dhe jam i sigurt që edhe ato biznese përfitojnë mjaft.

**Fitneta Bejtë:** - tha se propozimi i asamblistes ishte shumë i duhur, por ne si asamblistë duhet me ndiku që këto kategori me u specifiku që mos me i pas keqkuptimet e tyre. Shumë lehtë e kemi me kodet e biznesve që janë në regjistrin e ARBK-së, mund t'i caktojmë dy apo tri kode dhe kryeshefit të "Pastrimit" ia lehtëson punën. Kjo rregullore specifikon shumë detaje që i kanë munguar rregulloreve të kaluara. Lidhur me vërjetjet dhe shqetësimet e dhëna nga parafolësit, sqarime shtesë dha Ilirik Musliu - drejtor.

**Kryesuesi** e hodhi në votim propozimin e znj. Saraçi.

**Kryesuesi konstatoi se më 24 vota për, 2 kundër dhe 8 abstenime, u miratua propozimi i znj. Saraçi.**

**Kryesuesi konstatoi se më 28 vota për dhe 2 kundër, u miratua Rregullorja përmenaxhimin e mbeturinave dhe Plani komunal i menaxhimit të mbeturinave 2023-2027.**

### Pika e tretë

**Propozim-rregullorja përmëpëcaktimin e procedurave dhe formave përdhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës përmë pak se një vit.**

Me propozimin e kryesuesit dhe në mungesë të drejtore Doruntinë Maloku, prezantimin dhe arsyeshmërinë përvotimin e kësaj rregulloreje e paraqiti drejtori Ilirik Musliu.

**Nora Kelmendi:** - ngriti sheqtësim rrëth kësaj rregulloreje e cila tha se rregullorja në fjalë nuk përkon me rregulloren të cilën e prezantoi drejtori Ilirik, kështu që ne përkëtë rregullore kemi këto vërjetje:

Në nenin 6 duhet të shtohet edhe nënparagrafi 2 si në vijim: kompensimi përdhënien në shfrytëzim i pronës së paluajtshme të komunës përmë pak se një vit, të përcaktohet me rregullore të komunës përtaksa komunale, jo me çmimore të Ndërmarrjes Publike Banesore.

Në neni 8, duhet të shtohen edhe disa paragrafë, kështu që kërkesa duhet t'i drejtohet organit kompetent, pra drejtorive përkëtëse të komunës, jo vetëm Drejtorisë së Pronës dhe Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

Tek neni 9 po ashtu duhet të shtohet edhe një paragraf, ku e parashev formularin e plotësuar me të dhënat e kërkura nga drejtoria përkatëse.

Neni 10 – shqyrtimi i kërkësave, duhet të ketë emërtimin: formimi dhe përbërja e komisionit, sepse fillimisht duhet të formohet komisioni e pastaj të shqyrtohen kërkësat.

Neni 11 mendoj se duhet të ndryshohet, pasi që edhe kryetari duhet ta formojë komisionin në mënyrë që të parashtron ankesat, kështu që pa u formuar komisioni nuk mund të parashtron ankesat. Gjithashtu mirë kish me qenë të jenë edhe dy nënparagrafe, nene të reja, të parashihet edhe konflikti i interesit, këtë nuk e keni shtuar askund.

Neni 12 – dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme të komunës përmë organizatat e shoqërisë civile, këtu paragrafi 2 ku ceket që prona e komunës jepet në shfrytëzim jo më shumë se 5 ditë. Ky paragraf mendoj se nuk është në rregull, pasi që organizatat e shoqërisë civile, të cilat ushtrojnë

veprimitari apo aktivitete për persona me nevoja të veçanta t'ju jepet në shfrytëzim prona e komunës më pak se 5 ditë, mendoj se është pak.

Neni 13 gjithashtu duhet të vendoset një paragraf i ri i cili thotë: e drejta e shfrytëzimit më pak se një vit nuk mund të bartet te personat e tretë dhe vëretje tjera rrëth nenit që parasheh dispozitat ndëshkuese. Mendoj me këtë rregullore po shfuqizoni një rregullore që nuk ka të bëjë fare më Rregulloren për dhënien në shfrytëzim deri në një vit.

**Jeta Rafuna Hasani:** - tha se kjo rregullore do t'ia shtojë edhe vlerën pronës komunale dhe të vendos ligjshmëri në shfrytëzim të pronave, si dhe do të rritë të hyrat e kryeqytetit. Rregullorja për dhënien në shfrytëzim, përveç qe disa vite ka qenë kriter ligjor, ka qenë edhe demosdoshmëri përmbarvajtjen e punëve në Prishtinë. Ne si grup i asamblistëve të LDK-së jemi për këtë rregullore dhe do të votojmë për.

**Gëzim Sveçla:** - tha se do të ishte mirë që paraprakisht të ndryshohet tarifa e pastaj të vijë kjo rregullore, për shkak se në këtë situatë, kjo projektrregullore që po tentohet të kalojë sot po bazohet në çmimet e një dokumenti që nuk është i Kuvendit Komunal dhe kjo paraqet shkelje ligjore edhe si e tillë është vështirë se e kalon ligjshmërinë, duke e pas parasysh urgjencën që ia keni dhënë kësaj rregulloreje qysh nga seanca e jashtëzakonshme dhe sot. Mendoj që këto gabime po kushtojnë dhe është e paspjegueshme si po punoni pa e pasur një zyrtar ligjor këtu që t'na jep interpretimë të sakta.

Lidhur me vërejtjet dhe shqetësimet e ngritura nga parafolësit, sqarime shtesë dhanë Ilirik Musliu - drejtor dhe Alban Zogaj - nënkyrjetar.

**Kryesuesi konstatoi se më 23 vota për, u miratua Rregullorja për përcaktimin e procedurave dhe formave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për më pak se një vit.**

#### Pika e katërt

**Propozim-rregullorja për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores mbi taksën administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe tarifën për rregullimin e infrastrukturës, 01-434/01-0094474/17, dt. 24.04.2017.**

Arsyeshmërinë për votim të kësaj pike të rendit të ditës e paraqiti Arbër Sadiki - drejtor.

**Nora Kelmendi:** - tha se e dijmë që pritja e gjatë përmarrjen e lejes së ndërtimit është një problem mjaft i madh në Komunën e Prishtinës. Numri i madh i kërkesave për leje të ndërtimit, mosmbajta e lëndëve në mënyrë të organizuar, mënyra e kompletimit të lëndës nga ana e zyrtarëve janë duke shkatuar vonesa të mëdha në lëshimin e lejeve të ndërtimit. Lejet ndërtimore duhet të lëshohen nga organi kompetent brenda 30 ditëve, kështu që do të ishte mirë që të përkujdeseni që lejet ndërtimore të shqyrtohen brenda afatit ligjor, pra të respektohen afatet ligjore.

**Lendita Rexhepi:** - tha se qëllimi kryesor i kësaj rregulloreje është plotësimi, ndryshimi i Rregullores mbi taksën administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe tarifën e rregullimit të infrastrukturës. Qytetarët vazhdimesh kanë pasur ankesa për kualitetin e ndërtimit dhe ky është një

mekanizëm kryesor që i filtron investorët serioz. Ne si gurp pralamentar i LDK-së e përkrahim këtë plotësim-ndryshim të rregullores për miratim.

**Bahri Gashi:** - tha se nëse vazhdohet me këtë trend që të ngarkohen bizneset që merren me ndërtim, do të jetë një ngarkesë financiare për ta, kështu që pagesa për leje të jetë në formën me këste e jo me 2.5% me para të gatshme në fillim të vitit, sepse është një shumë tejet e madhe e mjeteve finniciare.

**Gëzim Mehmeti:** - tha se nuk është i analizuar mirë ky plotësim-ndryshim i kësaj rregulloreje, pasi që koha në të cilën gjendet tash kriza ekonomike, pastaj çështja e rritjes së kamatave të bankave, çështja e moshitjes, ka impakt negativ te bizneset e ndërtimit. Tani duhet gjetur metoda si të bëhet inkasimi. Mendoj se nuk është koha që tash të inkasohet, sepse do të kushtojë shumë, shumë në këtë drejtim dhe nuk është koherent me rrethanat që i kemi ne.

Lidhur me shqetësimet e ngritura nga parafolësit, sqarime shtesë dha Arbër Sadiki - drejtor.

**Kryesuesi konstatoi se më 24 vota për, u miratua Rregullorja për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores mbi taksën administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe tarifën për rregullimin e infrastrukturës, 01-434/01-0094474/17; dt. 24.04.2017.**

*Pas votimit të kësaj pike të rendit të ditës, GP i LVV-së, GP i AAK-së, dhe një anëtar i GP të AKR-së e lëshuan mbledhjen.*

#### **Pika e pestë**

**Propozim-vendimi për caktimin e shkallës tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2024.**

Arsyeshmérinë për votimin e kësaj pike e paraqiti Valbona Makolli, - drejtore.

**Kryesuesi konstatoi se më 26 vota për, u miratua Vendimi për caktimin e shkallës tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2024.**

#### **Pika e gjashtë**

**Propozim-vendimi për heqjen e taksës për vulën në transaksion.**

Lidhur me këtë pikë, arsyeshmérinë për votimin e saj e paraqiti Valbona Makolli - drejtore.

**Kryesuesi konstatoi se më 26 vota për, u miratua Vendimi për heqjen e taksës për vulën në transaksion.**

#### **Pika e shtatë**

**Propozim-vendimi lidhur me Planin e integritetit në Kryeqytetin Prishtinë 2023-2026.**

Për këtë pikë të rendit të ditës, të pranishmit në pika të shkurta i informoi Osman Bllaca - auditor.

**Kryesuesi konstatoi se më 26 vota për, u miratua Vendimi lidhur me Planin e integritetit në Kryeqytetin Prishtinë 2023-2026.**

## Pika e tetë

**Propozim-vendimi lidhur me Planin lokal të veprimit për cilësinë e ajrit në Komunën e Prishtinës 2023-2027.**

Për këtë pikë të rendit të ditës, të pranishmit në pika të shkurta i informoi Ilirik Musliu - drejtor.

**Kryesuesi konstatoi se më 26 vota për, u miratua Vendimi lidhur me Planin lokal të veprimit për cilësinë e ajrit në Komunën e Prishtinës 2023-2027.**

## Pika e nëntë

**Raport periodik për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit për vitin 2022.**

Për këtë pikë të rendit të ditës, të pranishmit i informoi Osman Blaaca - auditor.

**U konstatua se u përkrah Raporti periodik për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit për vitin 2022.**

## Pika e dhjetë

**Projektrregullorja për organizimin dhe shfrytëzimin e parkingjeve të Komunës së Prishtinës.**

Lidhur me këtë projektrregullore, të pranishmit i informoi Florian Dushi – drejtor, i cili tha se duke parë disponimin e grupeve parlamentare dhe të asamblistëve prezent, kërkoi që shqyrtimi i kësaj rregulloreje të bëhet në njëren prej seancave të radhës të Kuvendit.

*Kryesuesi konstatoi se me kërkesën e z. Florian Dushi - drejtor dhe me pëlgimin e anëtarëve të Kuvendit, Projektrregullorja për organizimin dhe shfrytëzimin e parkingjeve të Komunës së Prishtinës, do të trajtohet në njëren prej seancave të radhës të Kuvendit.*

*Mbledhja përfundoi në orën 18:30.*

Procesmbajtësi  
Zijadin Gashi



Faqe9nga9